



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA

KOMISIONI I PAVARUR I MEDIAVE  
NEZAVISNA KOMISIJA ZA MEDIJE  
INDEPENDENT MEDIA COMMISSION



N.SH. Dream  
Javier PULA  
Pronar  
OK NSH Dream  
Komuna e Dragashit

Ref: 1406/740/KPM/ni

D.SH. SPEED TV  
Nr. i biznesit 70795833  
Jaser SPAHIU  
Kandidat për Pronar  
Restelicë,  
Komuna e Dragashit

## VENDIM

*për ndryshimin e pronësisë dhe emrit të Operatorit Kabllor NSH DREAM - Dragash*

### Faktet

1. Komisioni i Pavarur i Mediave (KPM), në bazë të nenit 3, paragrafi 2.6. të ligjit për KPM (Ligji nr. 04/L-44), nxjerr akte nënligjore për rregullimin e transmetimit dhe të shërbimeve mediale audio-vizuale, të cilat nevojiten për të kryer funksionet e saj në pajtim me standardet ndërkombëtare.
2. N.SH. DREAM është operator kabllor, i cili është i licencuar për të shpërndarë programe përmes rrjetit kabllor në komunën e Dragashit. N.SH. DREAM është pajisur me licencë të KPM-së më datën 7 korrik 2010 dhe afati i vlefshmërisë së saj është 10 vite.
3. Më datën 22 prill 2014, pronari i N.SH. DREAM ka dorëzuar në zyrën e KPM-së një kërkesë për ndryshimin e pronësisë së Operatorit Kabllor, përmes së cilës ka kërkuar ndërrimin e pronësisë së N.SH. DREAM duke e propozuar kandidatin për pronarë z. Jaser SPAHIU në emër të subjektit D.SH. SPEED TV.
4. Në bazë të udhëzimit të KPM-së, të datës 15 maj 2014, për plotësim të kërkesës me dokumentet përkatëse, kandidati për pronarë të ri i D.SH. SPEED TV për licencë të KPM-së, me datën 29 maj 2014 ka dorëzuar dokumentet e kërkuara dhe ka plotësuar kërkesën e tij.

5. Me anë të një deklarate si pjesë e kërkesës për ndryshimin e pronësisë kandidati për pronarë të ri të D.SH. SPEED TV z. Jaser SPAHIU, është zotuar se do të veprojë në pajtim me Kushtet dhe termet e përgjithshme të licencës së KPM-së Ligjin dhe rregulloret e KPM-së.
6. Kandidati për pronarë të ri D.SH. SPEED TV, përmes të njëjtës deklarate ka kërkuar edhe miratimin e ndryshimit të emrit nga NSH DREAM në “D.SH. SPEED TV”.

### Arsyetimi

7. Neni 21, paragrafi 1 i Ligjit të KPM-së përcakton se: *“për të ushtruar transmetim në Kosovë sipas kushteve të këtij ligji kërkohet licenca për transmetim, të cilën e lëshon KPM-ja”*.
8. Neni 21, paragrafi 3 i Ligjit të KPM-së përcakton se: *“licencat nuk mundë të shfrytëzohen dhe bartën pa autorizim dhe pa aprovim paraprakë me shkrim të KPM-së”*.
9. Neni 15. pika 2. Paragrafi 1 i Kushteve dhe termeve të Përgjithshme të Licencës së KPM-së ka siguruar që: *“Për çdo ndryshim në pronësi që kap më shumë se 10% të aksioneve të interesave ose ato që kanë ndikim të theksuar në kontrollin e të Licencuarit, kërkohet paraprakisht aprovimi me shkrim nga ana e KPM-së”*
10. Neni 15.4 i Kushteve dhe termeve të Përgjithshme të Licencës së KPM-së ka siguruar që: *“KPM-ja do të lejojë transferimin e licencës vetëm kur sigurohet që personi fizik apo juridik, për të cilin propozohet që t’i transferohet licenca, i plotëson standardet e KPM-së për t’iu dhënë një licencë.”*
11. Prandaj, në pajtim me nenin 15.4 të Kushteve dhe Termeve të Përgjithshme të Licencës, KPM konkludon se kandidatit të propozuar për pronar t’i transferohet licenca, i përmbush kriteret dhe standardet e kualifikimit për licencë të KPM-së.
12. Arsyetimin për bartje të pronësisë nga ana e parashtruesit të kërkesës, Komisioni e pranon si të mjaftueshëm.
13. Gjithashtu, KPM konstaton se emri i propozuar “D.SH SPEED TV” nuk është i ngjajshëm me emrin e ndonjë operatori kabllorë të licencuar në Republikën e Kosovës dhe nuk paraqet problem gjatë identifikimit me operatorët tjerë dhe mbi këtë arsye edhe mund të ndryshohet.

### VENDIM

14. KPM merr vendim për ndryshimin e pronësisë së N.SH. DREAM në pajtim me kërkesën e parashtruar, duke e bartur pronësinë tek subjekti N.SH. “SPEED TV” me pronarë z. Jaser SPAHIU.

15. KPM merr vendim për ndryshimin e emrit të operatorit kabllor nga N.SH. DREAM në D.SH. SPEED TV, në pajtim me kërkesën e kandidatit të ri për pronarë.

**Lëshimi i Vendimit**

16. Këtë vendim e lëshon Komisioni i Pavarur i Mediave dhe i njëjti është i vlefshëm që nga data e nënshkrimit të tij.

  
Adnan MEROVCI  
Kryetar  
Komisioni i Pavarur i Mediave



11.06.2014  
datë